



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura III  
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit  
P-122  
Prishtinë, më 12 tetor 2010, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**P R O C E S V E R B A L**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 12 TETOR 2010

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Naim Maloku, Nexhat Daci, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Slllobodan Petroviq dhe Numan Baliq, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ismet Beqiri, Ibrahim Makolli, Xhezair Murati dhe Branislav Gërbić.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Skënder Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga ZCN: Blerta Bejtullahu,  
Nga OSBE: Floriana Shala dhe  
Nga NDI: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë:

### **R e n d d i t e**

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 05 tetor 2010,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

#### **1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 5 tetor 2010**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 5 tetor 2010, u miratua pa vërejtje.

#### **2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës**

**Kryesia** shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç dhe me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare vendosi që mbledhja e radhës e Kuvendit të mbahet më 14 tetor 2010, me këtë:

### **R e n d d i t e**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Patenta,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës, dhe
7. Shqyrtimi i Rekomandimit për Propozim-Strategjinë dhe vendimin e Qeverisë së Kosovës për privatizimin e Postë -Telekomit të Kosovës.

#### **3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave**

##### **3.1 Kërkesa për debat parlamentar lidhur me garancionin bankar të operatorit mobil “Kosmocell”**

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e deputetit Dritan Tali, i përkrahur nga 5 deputet të tjerë, për debat parlamentar lidhur me garancionin bankar të operatorit mobil “Kosmocell”, vendosi që kjo pikë të radhitet për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

### **3.2 Mocioni i Grupit të grave deputete për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhjet**

Kryesia, pasi e shqyrtoi mocionin e Grupit të grave deputete për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhjet, nxori këtë:

## **P Ë R F U N D I M**

Kuvendi është në pritje të procedimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhjet nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

### **3.3 Rekomandimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2009**

Kryesia u njoftua me rekomandimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2009.

### **3.4. Rekomandimi i Komisioni për Buxhet dhe Financa për ridestinimin e projekteve kapitale në buxhetin e Kuvendit të Kosovës, për vitin 2010**

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e Komisionit për Buxhet dhe Financa për ridestinimin e projekteve kapitale në buxhetin e Kuvendit të Kosovës për vitin 2010, mori këtë:

## **V E N D I M**

1. Miratohet kërkesa e Komisionit për Buxhet dhe Financa për ridestinimin e projekteve kapitale në buxhetin e Kuvendit të Kosovës për vitin 2010, si vijon:
  - a) Transferimi i mjeteve buxhetore nga Projekti kapital: Rregullimi i oborrit, të tarracave dhe të parkingut, në vlerë 35,000 euro, në Projektin e ri kapital: Gëlqerosja e objektit, në vlerë prej 35,000 euro.
  - b) Transferimi i mjeteve buxhetore nga Projekti kapital: Rinovimi i ujësjellësit dhe kanalizimit, shuma e mbetur pas përfundimit të projektit prej 4,212 euro dhe blerja e fotokopjeve, shuma e mbetur pas përfundimit të projektit prej 628 euro, në Projektin kapital: Blerja e dy kombibuseve, në vlerë prej 4, 840 euro.
2. Ministri i Ekonomisë dhe Financave të autorizojë ridestinimin e projekteve kapitale në Buxhetin e Kuvendit të Kosovës, për vitin 2010.

### **3.5 Propozim-Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me propozimin e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale**

Kryesia, pasi e shqyrtoi Propozim-Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me propozimin e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale, nxori këtë:

#### **P Ë R F U N D I M**

Ngarkohet Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksional, që ta shqyrtojë Propozim-Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me propozimin e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

### **3.6 Propozim-Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin e Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar**

Kryesia, pasi e shqyrtoi Propozim-Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin e Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, nxori këtë:

#### **P Ë R F U N D I M**

Ngarkohet Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksional, që ta shqyrtojë Propozim-Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin e Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

### **3.7 Kërkesa e Bordit të BQK-së për rishqyrtimin e Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Kosovës, për vitin 2009**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Bordit të BQK-së për rishqyrtimin e Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Kosovës, për vitin 2009, nxori këtë:

#### **P Ë R F U N D I M**

Kërkesa e Bordit të BQK-së i dërgohet Komisionit për Buxhet dhe Financa për të vlerësuar nëse ka arsye për rishqyrtimin e Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Kosovës, për vitin 2009.

### **3.8 Shqyrtimi i kërkesës për shpalljen e konkursit për zëvendësit e Avokatit të Popullit**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën për shpalljen e konkursit për zëvendësit e Avokatit të Popullit, nxori këtë:

## **P Ë R F U N D I M**

Ngarkohet Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi që, në pajtim me Ligjin për Avokatin e Popullit, ta hartojë dhe Kuvendit t'ia paraqesë për miratim Rregulloren për procedurën e zgjedhjes dhe të shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të Avokatit të Popullit.

### **3.9 Shqyrtimi i Propozim-Rregullore për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës**

Kryesia, pasi shqyrtoi Propozim-Rregulloren për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, mori këtë:

## **V E N D I M**

1. Miratohet Rregullorja për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës Kosovës me rekomandimet, si në vijim:
  - a) Në nenin 20 pika (f) të Rregullore për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës, riformulohet, si vijon: “ Mbikëqyrja e punëve kontraktuese ditore”;
  - b) Në faqen 66 të përshkrimit të punëve, në pikën e parë fshihen fjalët në kllapa (restoranti dhe shërbimi mjekësor).
  - c) Aneksi për organizimin e Zyrës për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërparlamentare të behët pjesë përbërëse e Rregullore për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit, si dhe përshkrimin e punëve.
2. Sistematizimi i punëve dhe Organogrami të bëhet në pajtim me Rregulloren e re.
3. Kontratat e punës të zyrtarëve të Administratës së Kuvendit të bëhen konform Ligjit për Shërbimin Civil dhe Ligjit për pagat e shërbyesve civilë, ndërkohë që ngritja eventuale e koeficienteve të zyrtarëve të bëhet në bazë të vlerësimit vjetor, në propozim të udhëheqësit të drejtpërdrejtë, me miratim të sekretarit të Kuvendit.
4. Kontratat për kryerjen e Shërbimeve kontraktuese të jenë në pajtim me Ligjin për prokurimin publik.
5. Hiqet shërbimi kontraktues shëndetësor nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

### **Pikat shtesë:**

### **3.10. Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e udhëtimit zyrtar në SHBA**

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e deputetes Donika Kadaj - Bujupi për lejimin e udhëtimit zyrtar në SHBA, mori këtë:

## V E N D I M

Kryesia e Kuvendit nuk miratoi kërkesën e deputetes Donika Kadaj - Bujupi për të marrë pjesë në konferencën me temë “Trafikimi i qenieve njerëzore, të grave dhe të vajzave”, që do të mbahet më 15-23 tetor 2010, në Uashington DS, SHBA, me arsyetimin se kërkesa nuk është në pajtim me vendimin e Kryesisë së Kuvendit, nr. 03-V-094.

### 3.11 Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e udhëtimit zyrtar në Sllovaki

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën për lejimin e udhëtimit zyrtar në Sllovaki të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në përbërje: z. Arsim Bajrami, znj. Gjylnaze, z. Bahri Hyseni dhe znj. Rita Hajzeraj, mori këtë:

## V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në përbërje: Bahri Hyseni, Arsim Bajrami, Gjylnaze Sylja dhe Rita Hajzeraj prej 03 deri më 06 nëntor 2010.
2. Shpenzimet e transportit, të akomodimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurit në paragrafin një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori, ndërsa mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, në përputhje me vendimin e Kryesisë së Kuvendit nr. 03-V-094.

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 13:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit,  
**Jakup KRASNIQI**

Procesverbalin e hartoi:  
Divizioni për çështje plenare dhe procedurale